



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/54
Datë: 13.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 53 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/54
Datë: 13.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme që në Strategjinë Legjislative për vitin 2009 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përfshihet edhe :
 - Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 2003/17.
2. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike në Zyrën Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/54
Datë: 13.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Themelohet grupi punues qeveritar për harmonizimin e qëndrimeve dhe finalizimin e Projektligjit për Qeverinë, në këtë përbërje:
 - a) Z. Ramë Manaj, Zëvendëskryeministër - Kryesues
 - b) Z. Arsim Bajrami - Ministër i Ministrisë së Shërbimeve Publike
 - c) Znj. Nekibe Kelmendi - Ministre e Ministrisë së Drejtësisë
 - d) Z. Ahmet Shala - Ministër i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe
 - e) Z. Sadri Ferati - Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë